

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Një telefonatë në 999 zbuloi gjithçka, si u kapën 5 britanikët pranë bazës së RAF-it - Euronews Albania
ADRESA	https://euronews.al/nje-telefonate-ne-999-zbuloi-gjithcka-si-u-kapen-5-britaniket-prane-bazes-se-raf-it/
BURIMI	euronews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 13:54:30 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 13:52:25 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	0c13bcc3ad185deb45cf5542402426fac9ba4a11b1abfab5c5cb9a9559809d64
TEKSTI	f1c6305adbc3728a90373d4ffe6bd181b5892ce370b91c1f16db894e88ab0f62
PAMJA	25b3139bdd71e1b02110e4430b825d4c19d8b30983d744ed17da0d15e8640655

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	9b59231973dacc452f7953094a367301d361854ae9880fff30417700e00877b
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	282274d0ff18f09ea4854e79728659ffe2d6cd028bfa2085cb95da6ce0a699bb
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/9b59231973dacc452f7953094a367301d361854ae9880fff30417700e00877b>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

TREND

Edi Rama Lufta në Iran SHBA Kuvendi i Kosovës Rusia

BOTA | EVROPA

Një telefonatë në 999 zbuloi gjithçka, si u kapën 5 britanikët pranë bazës së RAF-it

28 Shtator 2026 | 15:52

Pesë shtetas britanikë nga Londra, të moshës 23 deri në 25 vjeç, janë personat e arrestuar pranë bazës ajrore RAF Fairford në Gloucestershire, në kuadër të një hetimi për përgatitjen e mundshme të një sulmi terrorist.

Komanda Britanike Kundër Terrorizmit konfirmoi të hënën se të pestë janë britanikë dhe mbeten në paraburgim, ndërsa hetimet vijnë për gjetjet në tre automjete të dyshimta të ndaluara pranë bazës. Tre nga të arrestuarit janë nga Westminster, një nga Camden dhe një nga Willesden, Londër.

Burrat u arrestuan fillimisht sipas ligjeve për eksplozivët dhe më pas u riarrestuan me dyshimin për përgatitjen e një akti terrorist. Sipas ligjeve britanike kundër terrorizmit, ata mund të mbahen në paraburgim deri në 14 ditë pa u akuzuar.

Operacioni nisi në orët e para të mëngjesit të së dielës, kur banorët vendas njoftuan policinë për tre automjete të dyshimta që po shkonin drejt RAF Fairford.

Telefonata e parë erdhi rreth orës 00:45 dhe oficerë të armatosur u dërguan në zonën e Whelford, në një distancë të shkurtër nga baza, ku gjetën dhe arrestuan pesë burrat.

Pas arrestimeve nisi një operacion i gjerë, me ekipet e çaktivizimit të bombave të Ushtrisë Britanike që ekzaminuan tre furgonët e bardhë, duke përfshirë edhe përdorimin e një roboti me telekomandë. Rreth 85 shtëpi në zonë u evakuuan si masë paraprake dhe u krijua një zonë përjashtimi prej qindra metrash.

Sipas gazetës The Guardian, hetuesit po shqyrtojnë materialet e gjetura në automjete, ndërsa vlerësimet fillestare tregojnë se ato mund të lidhen me pajisje shpërthyes të improvizuara. Vlerësimi i gjetjeve është ende në vazhdim.

Një nga pyetjet kryesore të hetimit është motivi i pesë burrave dhe nëse ata po vepronin në emër të një fuqie të huaj apo të një organizate tjetër.

Mediat britanike raportojnë se po shqyrtohet, ndër të tjera, edhe një lidhje e mundshme me Iranin. Megjithatë, autoritetet deri më tani nuk ia kanë atribuar zyrtarisht rastin Teheranit dhe nuk kanë njoftuar se burrat e arrestuar po vepronin në emër të shtetit iranian.

Baza ajrore RAF Fairford ka një rëndësi të veçantë strategjike, pasi përdoret nga Forcat Ajrore të Shteteve të Bashkuara dhe ka shërbyer si bazë për bombarduesit amerikanë në operacionet që lidhen me luftën me Iranin.

Ambasada iraniane në Londër ka bërë një deklaratë të fortë kundër këtyre arrestimeve, duke i përshkruar ato si veprim të padrejtë dhe të paarsyeshëm.

LAJMI I FUNDIT

15:30 Ekosistemi shqiptar i inovacionit prezantohet në Bits & Pretzels: 17 startupe, nga Shqipëria, Kosova dhe diaspora

15:27 Fier, policia shton kontrollet në akset rrugore, mbi 1000 gjoba

15:22 Shpërblim për zjarrfikësit e Tiranës, Veliaj çon projektvendimin në Këshillin Bashkiak

15:13 Irani mohon kategorikisht çdo lidhje me incidentit e rëndë në bazën amerikane në Britani

14:44 Irani ankesë në OKB për sanksionet amerikane në sektorin e aviacionit

14:41 3 policë qëllohen për vdekje në Pakistanin veriperëndimor, plagosen 2 kalimtarë

TESTIM

Ambasada iraniane në Londër njoftoi për një raport të kategorizuar si "përkrahje", duke i përshkruar raportet si "spekulime të pabaza dhe keqdashëse" dhe duke pretenduar se ato kontribuojnë në kultivimin e "iranofobisë" në Britani.

Kreu i Departamentit Britanik të Kundër-Terrorizmit, Zëvendës Ndhmës Komisionerja Vicky Evans, e përshkroi operacionin si "jashtëzakonisht kompleks dhe në shkallë të gjerë", që përfshinte policinë lokale dhe kombëtare, Ministrinë e Mbrojtjes dhe agjenci të tjera.

Sipas policisë, kërkimet e kryera gjatë natës kanë krijuar shumë pista të reja për hetim, ndërsa bllokada rreth RAF Fairford mbeti në fuqi të hënën.

Evans kërkoi gjithashtu që të shmangen spekulimet rreth motivit të të arrestuarve dhe dimensioneve gjeopolitike të çështjes, ndërsa hetimi vijon.

Një banorë vendase duket se ka luajtur një rol të rëndësishëm në mobilizimin e autoriteteve. Ajo po kthehej në shtëpi në orët e para të mëngjesit kur vuri re tre furgonët që bllokoni rrugën pranë bazës.

Gruaja telefonoi 999 dhe, sipas rrëfimit të saj, pa burra që largoheshin nga automjetet në drejtime të ndryshme. Ajo shprehu habi që ishte ajo që ngriti alarmin, ndërsa pretendoi se ende nuk është marrë në pyetje në detaje nga policia.

Sekretari i Mbrojtjes, Wes Streeting, vlerësoi reagimin e saj, duke thënë se ajo "bëri pikërisht atë që ne do të shpresonim se dikush do të bënte në një situatë si kjo", por vuri në dukje se ajo kishte vetëm një "pamje të pjesshme" të operacionit.

Në të njëjtën kohë, Donald Trump deklaroi se agjencitë amerikane dhe britanike "i njihnin" të dyshuarit dhe pretendoi se burrat po planifikonin të shkaktonin "dëme të mëdha". Autoritetet britanike nuk e kanë konfirmuar këtë version, ndërsa raportet tregojnë se operacioni fillestar policor nuk rezultoi nga një operacion i planifikuar inteligjence, por nga një telefonatë e bërë nga banorët.

Shiko në:

LAJME TË SUGJERUARA

BOTA

Irani ankesë në OKB për sanksionet amerikane në sektorin e aviacionit

Irani ka paraqitur një ankesë në OKB lidhur me sanksionet e SHBA-së kundër sektorit të tij të aviacionit, të cilat kanë detyruar anulimin e fluturimeve....

14:44 | 28/09/2026

BOTA

3 policë qëllohen për vdekje në Pakistanin veriperëndimor, plagosen 2 kalimtarë

Militantët vranë tre pjesëtarë të policisë rrugore në një pritë në veriperëndim të Pakistanit të hënën, tha Ministria e Brendshme. Incidenti ndodhi në...

14:41 | 28/09/2026

BOTA | EVROPA

Kriza e emigrantëve, përfaqësuesi i qeverisë spanjolle në Ceuta jep dorëheqjen

Përfaqësuesi i Spanjës në enklavën e saj të Afrikës Veriore, Ceuta, dha dorëheqjen të hënën, duke përmendur arsye personale pas disa javësh shqyrtimi intensiv mbi...

14:39 | 28/09/2026

TEMA

Vendi
Rajoni
Bota
Video

SHËRBIME

Live
Lajmi fundit
Na ndiqni
Euronews Radio
Për persona me aftësi të kufizuara
Rreth Euronews
Kushtet e përdorimit
Politika e cookie
Kontakttoni
Punësimi

KOMPANIA

Follow Euronews on all platforms:

Copyright © Euronews 2026

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.